

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zjarret në vend/ Flakët "përpijnë" masivin pyjor në Tërbun të Pukës, rrezikohet 'kurora' e qytetit! Situata problematike edhe në Fier (PAMJET)
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/zjarret-ne-vend-vatrat-me-problematike-ne-dajt-bardhaj-te-shkodres--i512803
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 16:33:03 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 14:56:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c73d7028b27350f9166363f08b6610f685194b7d8d88b4fb567b7d8c807a1d51
TEKSTI	820afacc41255f1b0f54eb4c93d012bf0e707c041c750d8c13168ee484b5ba54
PAMJA	5b42362410626163087b65751e22f1b6691671958002de9c5be811a646bd2986

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	dcb93688fb8728c2b862d64e4338afce33777e2e8b0a644345c1f001c79d53dc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	af509d61787472ec8e41e2e6baaa0db3fd07d4af4f7a54c9293cb47ba3acab88
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/dcb93688fb8728c2b862d64e4338afce33777e2e8b0a644345c1f001c79d53dc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [KREU](#)
- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKE](#)
- [EKONOMI](#)
- [BOTA](#)
- [SPORT](#)
- [ART&ARGËTIM](#)
- [INSIGHTS](#)
- [EDITORIAL](#)



Mundesuar nga

LIVE UPDATES
2 ORE ME PARE LIVE UPDATES E. D

["Nuk shitet Shqipëria"/ 99 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion](#)

"Dy kërkesa janë urgjente, dorëheqja e Ramës dhe qeveria teknike"/ Protestuesi: Nesër 100-ditëshi, protestë k...

3 ORE ME PARE LIVE UPDATES E. D

["Diaspora në SHBA fat i mirë i kombit shqiptar"/ Berisha me shqiptarët në New Jersey: Ata që firmosën ndalimin tim, sot janë non-grata në vendin e tyre](#)

Berisha nga SHBA: Nga kjo platformë kam një kushtim për të gjithë shqiptarët në botë, Shqipëria du...

5 ORE ME PARE LIVE UPDATES E. D

[Zjarret në vend/ Flakët "përpijnë" masivin pyjor në Tërbus të Pukës, rrezikohet 'kurora' e qytetit! Situata problematike edhe në Fier \(PAMJET\)](#)

Vatër zjarri në kodrat e Peshkëpisë në Selenicë, era favorizon përhapjen e flakëve 6 Shtator, 16:26 ...

5 ORE ME PARE LIVE UPDATES E.D

[Operacion anti-drogë në Sarandë/ Arrestohen 20 persona, mes tyre 'koka' e grupit Altin Arapi! Shisnin hashash e kokainë pranë plazheve \(EMRAT+PAMJET\)](#)

Zbulohet si funksiononte skema e shitjes së drogës në Ksamil, anëtarët e grupit vinin nga Tirana dhe Elbasani vetë...

LIVE UPDATES

Zjarret në vend/ Flakët "përpijnë" masivin pyjor në Tërbus të Pukës, rrezikohet 'kurora' e qytetit! Situata problematike edhe në Fier (PAMJET)

• 20 vatra zjarri janë raportuar gjatë ditës, 11 prej të cilave mbeten ende aktive, ndërsa 7 janë nën mbikëqyrje. • Vëmendja kryesore vijon të jetë te Mali i Dajtit, ku zjarri mbetet aktiv dhe ndërhyrja mbështetet edhe nga FA me efektivë, mjete dhe helikopter. • Situatë aktive paraqitet edhe në Dibër, veçanërisht në zonën Lundre–Madhesh të Matit, ndërsa në Lezhë, vijon puna në Kalivaç–Zimaj–Kashnjet. • Vatrat aktive janë edhe në Qarkun Shkodër dhe në Kulumri të Fushë-Arrëzit. • Vatra aktive raportohen gjithashtu në Kropisht të Selenicës, Vokopolë të Poliçanit, Tërbus të Pukës dhe zona të tjera, ndërsa disa vatra në Korçë, Elbasan, Durrës, Fier, Kukës dhe Shkodër janë nën mbikëqyrje. • Edhe në Drizë–Peshtan–Frakull të Fierit, situata është nën mbikëqyrje. • Sa i përket zjarrit në Tërbus të Pukës, flakët janë përhapur masivisht, pasi janë favorizuar edhe nga era e forte, e cila ka përkeqësuar situatën. • Fatmirësisht deri në keto momente nuk rrezikohen banesa, por autoritet vendore kërkojnë mbështetje pasi era e fortë po përkeqëson situatën. • Në Tërbus, ky është zjarri i dytë brenda pak ditësh. • Edhe disa ditë më parë, zona u përfshi nga një tjetër zjarr i përmasave të mëdha, i cili dogji rreth 3 mijë hektarë sipërfaqe. • Zjarri është konstatuar në një tjetër pjesë të masivit pyjor. • Përhapja e flakëve mbetet shqetësuese për shkak të terrenit të vështirë dhe bimësisë së dendur, që favorizon përhapjen e zjarrit. • Dyshimet e para janë se zjarri mund të jetë i qëllimshëm, ndërsa pritet që autoritetet të kryejnë verifikimet për të përcaktuar shkaqet e rënies së flakëve

8 artikuj për këtë temë.

35 MINUTA ME PARE

Ministria e Mbrojtjes: 20 vatra ditën e sotme, 11 aktive dhe 7 nën monitorim

foto ilustruese

TIRANË- 20 vatra zjarri janë raportuar gjatë ditës, 11 prej të cilave mbeten ende aktive, ndërsa 7 janë nën mbikëqyrje. Vëmendja kryesore vijon të jetë te Mali i Dajtit, ku zjarri mbetet aktiv dhe ndërhyrja mbështetet edhe nga FA me efektivë, mjete dhe helikopter. Situatë aktive paraqitet edhe në Dibër, veçanërisht në zonën Lundre–Madhesh të Matit, ndërsa në Lezhë, vijon puna në Kalivaç–Zimaj–Kashnjet.

Vatrat aktive janë edhe në Qarkun Shkodër dhe në Kulumri të Fushë-Arrëzit. Vatra aktive raportohen gjithashtu në Kropisht të Selenicës, Vokopolë të Poliçanit, Tërbus të Pukës dhe zona të tjera, ndërsa disa vatra në Korçë, Elbasan, Durrës, Fier, Kukës dhe Shkodër janë nën mbikëqyrje. Edhe në Drizë–Peshtan–Frakull të Fierit, situata është nën mbikëqyrje. Sipas Ministrisë së Mbrojtjes, në operacionet për përballimin e situatës janë angazhuar strukturat vendore dhe Forcat e Armatosura, përfshirë kapacitete tokësore dhe ajrore.

Njoftimi:

Ministria e Mbrojtjes - përditësim mbi situatën e zjarreve. Përmbledhje e situatës së zjarreve – 6 shtator 2026, ora 20:00. Gjatë ditës janë raportuar 20 vatra zjarri, prej të cilave 11 mbeten aktive, 7 janë nën mbikëqyrje dhe 2 janë fikur.

Në operacionet për përballimin e situatës janë angazhuar strukturat vendore dhe Forcat e Armatosura, përfshirë kapacitete tokësore dhe ajrore.

Vëmendja kryesore vijon të jetë te Mali i Dajtit, ku zjarri mbetet aktiv dhe ndërhyrja mbështetet edhe nga FA me efektivë, mjete dhe helikopter; si dhe në Kryezi të Kavajës, ku krahas forcave zjarrfikëse është angazhuar edhe një avion Air Tractor.

Situatë aktive paraqitet edhe në Dibër, veçanërisht në zonën Lundre–Madhesh të Matit, ndërsa në Lezhë, vijon puna në Kalivaç–Zimaj–Kashnjet, me mbështetje edhe nga dy helikopterë të FA.

Në Qarkun Shkodër, zjarri Bardhaj–Myselim mbetet aktiv, në operacion janë angazhuar strukturat vendore, vullnetarët dhe FA, përfshirë 2 helikopterë. Aktiv mbetet edhe zjarri në Kulumri të Fushë-Arrëzit.

Vatra aktive raportohen gjithashtu në Kropisht të Selenicës, Vokopolë të Poliçanit, Tërbun të Pukës dhe zona të tjera, ndërsa disa vatra në Korçë, Elbasan, Durrës, Fier, Kukës dhe Shkodër janë nën mbikëqyrje. Në Drizë–Peshtan–Frakull të Fierit, situata është nën mbikëqyrje.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile vijon të ndjekë në mënyrë të pandërprerë situatën në të gjithë territorin e vendit, në koordinim të ngushtë me prefekturat, bashkitë dhe të gjitha strukturat e sistemit të Mbrojtjes Civile.

Kapacitetet operacionale mbeten të angazhuara në terren dhe në gatishmëri për të ndërhyrë aty ku situata e kërkon, me prioritet mbrojtjen e jetës, banesave dhe pasurisë së qytetarëve./Dosja.al

55 MINUTA ME PARE

PAMJE dramatike nga zjarri në Tërbun të Pukës, flakët shkrumbojnë masivin pyjor

Zjarret në vend/ Flakët "përpijnë" masivin

TIRANË- Pamje dramatike janë publikuar nga zjarri në masivin pyjor të Tërbunit, mbrëmjen e sotme. Siç shihet edhe në pamje, flakët janë përhapur masivisht, pasi janë favorizuar edhe nga era e forte, e cila ka përkeqësuar situatën. Në operacionin për shuarjen e flakëve janë angazhuar 2 mjete zjarrfikëse, 1 mjet fadrome, 15 efektiv zjarrfikës, 20 punonjës shërbimesh të forcave të policisë 6.

Fatmirësisht deri në keto momente nuk rrezikohen banesa. Autoritet vendore kërkojnë mbështetje pasi era e fortë po përkeqëson situatën. Në Tërbun, ky është zjarri i dytë brenda pak ditësh. Edhe disa ditë më parë, zona u përfshi nga një tjetër zjarr i përmasave të mëdha, i cili dogji rreth 3 mijë hektarë sipërfaqe.

Zjarri është konstatuar në një tjetër pjesë të masivit pyjor. Përhapja e flakëve mbetet shqetësuese për shkak të terrenit të vështirë dhe bimësisë së dendur, që favorizon përhapjen e zjarrit. Dyshimet e para janë se zjarri mund të jetë i qëllimshëm, ndërsa pritet që autoritetet të kryejnë verifikimet për të përcaktuar shkaqet e rënies së flakëve./Dosja.al

2 ORE ME PARE

VIDEO/ Bie zjarr pranë banesave në Krastë të Elbasanit, në rrezik dy shtëpi

Zjarret në vend/ Flakët "përpijnë" masivin

ELBASAN- Një vatër zjarri ka rënë pas Kodrës së Krastës në Elbasan, duke rrezikuar edhe dy banesa. Për izolimin e flakëve janë izoluar tre mjete dhe 12 efektivë.

Për shkak të afërsisë me banesat, ndërhyrja është fokusuar në izolimin e zjarrit dhe pengimin e përhapjes së tij drejt zonës së banuar. Pas ndërhyrjes së zjarrfikësve, vatra është neutralizuar, ndërsa nuk raportohet për persona të lënduar apo dëme në banesa./Dosja.al

5 ORE ME PARE

VIDEO/ Katër vatra zjarri regjistrohen në pyllin e Semanit, flakët përhapen me shpejtësi nga era

 Zjarret në vend/ Flakët "përpijnë" masivin

FIER- Një vatër zjarri masive po përhapet me shpejtësi në zonën e Semanit, në Fier, i favorizuar nga era e fortë. Situata paraqitet problematike, ndërsa ekipet zjarrfikëse të Fierit vijojnë prej orësh operacionin për shuarjen e flakëve dhe vënien nën kontroll të vatrave të zjarrit.

Shërbimet e emergjencës po punojnë për të parandaluar përhapjen e flakëve në sipërfaqe të tjera të pyllit. Po ashtu, era e fortë po vështirëson ndjeshëm ndërhyrjen dhe po favorizon përhapjen e zjarrit. Fatmirësisht, deri më tani, nuk raportohet për persona të lënduar./Dosja.al

5 ORE ME PARE

Vatër zjarri në kodrat e Peshkëpisë në Selenicë, era favorizon përhapjen e flakëve

 Zjarret në vend/ Flakët "përpijnë" masivin
pamjet

SELENICË- Një vatër zjarri ka rënë në kodrat e fshatit Peshkëpi, në territorin e bashkisë Selenicë. Flakët janë shfaqur në një zonë kodrinore, ku mbizotëron bimësia shkurre, duke rritur rrezikun e përhapjes së zjarrit në sipërfaqe të tjera.

Shkaqet e rënies së zjarrit ende nuk dihen, ndërsa pritet ndërhyrja e zjarrfikëse për të bërë të mundur izolimin dhe shuarjen e flakëve. Autoritetet po monitorojnë situatën, ndërsa mbetet për tu parë nëse zjarri do të përhapet drejt zonave të tjera./**Dosja.al**

10 ORE ME PARE

Zjarret në vend/ Ministria e Mbrojtjes: Janë raportuar 32 vatra, 11 janë ende aktive

Zjarret në vend/ Flakët "përpjënë" masivin
Zjarret

TIRANË- 32 vatra zjarri janë raportuar në të gjithë vendin gjatë 24 orëve të fundit. Sipas Ministrisë së Mbrojtjes, 11 prej tyre vijnë të jenë aktive, 5 janë nën mbikëqyrje, ndërsa 16 janë shuar.

Vëmendja kryesore është përqendruar në vatrat problematike në Dajt, Bardhaj të Shkodrës dhe Fier. Në Dajt po ndërhyjnë 77 forca ushtarake dhe një helikopter, ndërsa në Bardhaj operacioni vijon me forca zjarrfikëse, shërbimin pyjor, emergjencat civile dhe mbështetjen e FA-së.

Situata mbetet aktive edhe në Fier, ku janë angazhuar dhjetëra forca, mjete zjarrfikëse, një helikopter dhe një avion Air Tractor. Ndërkohë, zjarri në Himarë është shuar pas një operacioni të gjerë ku morën pjesë forca zjarrfikëse, bashkiake, policore, vullnetarë dhe efektivë të Forcave të Armatosura.

Njoftimi i Ministrisë së Mbrojtjes:

Ministria e Mbrojtjes informon se gjatë 24 orëve të fundit janë raportuar 32 vatra zjarri, nga të cilat 11 mbeten aktive, 5 janë nën mbikëqyrje dhe 16 janë fikur. Për përballimin e situatës është realizuar një angazhim i gjerë operacional në nivel kombëtar, me 735 forca vendore dhe 64 automjete zjarrfikëse. Forcat e Armatosura kanë mbështetur operacionet me 475 efektivë, 7 automjete zjarrfikëse, 4 helikopterë dhe 1 avion Air Tractor. Për ditën e sotme është parashikuar angazhimi i 160 forcave ushtarake në zonat ku ndërhyrja vijon.

Angazhimi kryesor është përqendruar në vatrat më problematike. Në Malin e Dajtit, krahas strukturave bashkiake, sot janë angazhuar 77 forca ushtarake dhe 1 helikopter. Në Bardhaj të Shkodrës, janë angazhuar 5 automjete zjarrfikëse, shërbimi pyjor, strukturat e emergjencave civile, si dhe mbështetje nga FA me 1 automjet zjarrfikës dhe 1 helikopter, ndërsa sot operacionit i shtohen 33 forca dhe 1 ambulancë. Në Fier, janë përfshirë 13 automjete zjarrfikëse, 4 autobote, 55 efektivë, 90 forca të tjera, si dhe 90 ushtarakë, 1 helikopter dhe 1 Air Tractor. Sot vijon mbështetja me 33 forca.

Operacioni në Himarë është përmbyllur me fikjen e zjarrit, pas një mobilizimi të gjerë me 26 automjete zjarrfikëse, 120 efektivë, 40 vullnetarë, 67 forca bashkiake, 20 forca policore dhe 180 efektivë të FA me 2 helikopterë. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) vijon të ndjekë në mënyrë të pandërprerë situatën në të gjithë territorin e vendit, në koordinim të ngushtë me prefekturat, bashkitë dhe të gjitha strukturat e sistemit të Mbrojtjes Civile. Kapacitetet operationale mbeten të angazhuara në terren dhe në gatishmëri për të ndërhyrë aty ku situata e kërkon, me prioritet mbrojtjen e jetës, banesave, pasurisë së qytetarëve dhe mjedisit./**Dosja.al**

11 ORE ME PARE

VIDEO/ Zjarri vijon prej 24 orësh në kodrat e Bardhajve, kërkohet ndërhyrje nga ajri për shkak të terrenit të vështirë

Zjarret në vend/ Flakët "përpjënë" masivin
Zjarr

SHKODËR- Zjarri vijon të jetë aktiv prej rreth 24 orësh në kodrat e Bardhajve në Shkodër, ku flakët kanë përfshirë një sipërfaqe të pyllëzuar.

Pamjet nga zona tregojnë përhapjen e flakëve, ndërsa situata mbetet problematike për shkak të terrenit të vështirë dhe kushteve të favorshme për përhapjen e zjarrit.

Në terren janë angazhuar dhjetëra forca të ushtrisë dhe shërbimit zjarrfikës, të cilat po punojnë për izolimin e vatrave dhe vënien nën kontroll të flakëve./Dosja.al

12 ORE ME PARE

VIDEO/ Zjarr në Syrin e Kaltër, digjen 4 kioska tregtimi

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.